



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1609/5 prot.

Datë 23.09.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 923/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.09.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-19625-02-14-2022, me objekt “*Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës*”, me fond limit 137.991.275 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 17.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

**Ankimues:** “Rej” SHPK  
Zogu i Zi, Qatar Center Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 15.02.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit *E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*, me Nr. REF-REF-19625-02-14-2022, me objekt Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 137,991,275 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 17.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 17.03.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 06.04.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të

Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Meteo” SHPK & “Pastrime Silvio” SHPK	106,899,711.43	I skualifikuar
2. “Rej” SHPK	113,365,021.65	I skualifikuar
3. “Clean Fast” SHPK	120,053,102.18	I skualifikuar
4. “Alko Impex General Construction” SHPK	121,432,903.81	I skualifikuar
5. “Sori AI” SHPK	136,612,710.76	I skualifikuar

II.4. Në datën 06.04.2022 operatori ekonomik “Rej” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 1, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se shërbimet e mëparshme, të kryera gjatë 3 viteve të fundit, nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit. Furnizimet e mëparshme, të paraqitura në SPE nga ofertuesi, kanë si objekt pastrimin e rrugëve, grumbullimin dhe transportin e mbetjeve për qytetet Pogradec, Përrenjas, Vlore si dhe shërbime të tjera mirëmbajtje të cilat nuk përbëjnë përvoja të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit (shërbim pastrimi i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të godinës).*
- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kritereve të Veçanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur në tabelën e punonjësve, të dhëna mbi kontraktimin e 38 punonjësve sanitarë nga gjithsej 42 të kërkuar në pikën 2 seksioni 2.3 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim. Punonjësit sanitarë të deklaruar në listën e stafit nga ofertuesi në nr. rendorë 42 deri 51, rezultojnë të mos jenë të kontraktuar siç kërkohet në pikën 2 seksioni 2.3 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim.*
- *Ofertuesi nuk përmbush piken 3/2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kritereve të Veçanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se nuk disponon në pronësi ose me qira “dy makina larëse për ambientet e brendshme”. Për këtë kërkesë Ofertuesi ka paraqitur një kontratë blerje me kusht me subjektin Globi ShPK nga ku rezulton se kjo e fundit ka ende pronësinë e makinave larëse, në kundërshtim me kërkesën e AK ku kërkohet shprehimisht që subjekti ofertues të disponojë në pronësi ose qira mjetet e kërkuara në momentin e hapjes së ofertave.*
- *Ofertuesi nuk përmbush piken 3/3, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kritereve të Veçanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se nuk disponon Makinë për larjen e rrugëve (Autobot) sipas kërkesave të AK. Nga leja e qarkullimit e paraqitur në SPE për autobotin AB048CF, rezulton se ky i fundit është dhënë me qira, pra nuk disponohet nga ofertuesi. Ndërsa, autoboti me targë*

*AA294FF, referuar fotos se paraqitur, nuk rezulton të jetë siç kërkohet në DST, i pajisur me pompe për larjen e rrugëve me presion dhe i pajisur me tub për nxjerrjen e ujit ne pjesët anesore te tij.*

II.5. Në datën 08.04.2022 autoriteti kontraktor, ka kryer Publikimin e Njoftim-Anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.6. Në datën 15.04.2022 operatori ekonomik “Rej” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.7. Pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Rej” SHPK, KPP mori vendimin KPP 463/2022, datë 16.05.2022, ku vendosi:

[...]

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-19625-02-14-2022, me objekt “Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 137,991,275 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 17.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.*
- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” SHPK.*
- 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.8. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), konstatohet, se në datën 19.05.2022, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit, si më poshtë vijon:

1. BOE “Meteo” SHPK & “Pastrime Silvio” SHPK	106,899,711.43	I skualifikuar
2. “Rej” SHPK	113,365,021.65	I kualifikuar
3. “Clean Fast” SHPK	120,053,102.18	I skualifikuar
4. “Alko Impex General Construction” SHPK	121,432,903.81	I skualifikuar
5. “Sori Al” SHPK	136,612,710.76	I skualifikuar

II.9. Në datën 23.05.2022 autoriteti kontraktor, ka kryer Publikimin e Njoftim të Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.10. Gjithashtu, në datën 07.06.2022 autoriteti kontraktor, ka kryer përsëri Publikimin e Njoftim të Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të autoritetit kontraktor, të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën objekt-shqyrtimi, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka dorëzuar dokumentin “*Procesverbal nr.4 i verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik “Rej” SHPK*”, të mbajtur në datë 23.06.2022 nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe përfaqësuesi i Njesisë së Prokurimit me përmbajtje: “*...Operatori ekonomik i shpallur fitues “Rej” SHPK, me shkresën protokolluar me tonë Nr.939 prot., datë 09.06.2022, ka paraqitur në formë të shkruar dokumentacionin si më poshtë...[...]. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm, rezulton se ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë dokument që provon disponueshmërinë/pronësinë e “Dy makina larëse për ambient e brendshme”. Sipas nenit 1 të kontratës për shitje mjetesh me kusht datë 15.03.2022, shitja e këtyre pajisjeve kushtëzohet nga shpallja fitues në këtë procedurë prokurimi. Si rrjedhim, ofertuesi kishte detyrimin që të paraqiste dokumentin provues të fitimit të pronësisë të 2 pajisjeve, brenda 5 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit. Pasi të kryhen verifikimet përkatëse për disponueshmërinë e pajisjeve të deklaruara siç përcaktohet në DST, dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi “Rej” SHPK, KVO do e përcjellë tek Njësia e prokurimit për ta bërë pjesë të dosjes së prokurimit”.*

II.12. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për procedurën objekt-shqyrtimi, konstatohet, se autoriteti kontraktor në datë 01.07.2022, në rubrikën “Kërkesa”, me anë të kërkesës “*Njoftim për verifikim*”, ka njoftuar operatorin ekonomik “Rej” SHPK se: “*Bazuar në pikën 3, shënim 5.1, seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST, sipas të cilës: “Autoriteti Kontraktor pas dorëzimit të dokumentacionit pas publikimit të njoftimit të fituesit përfundimtar, do të verifikojë pranë ambienteve të operatorit disponueshmërinë e pajisjeve të deklaruara”, ju njoftojmë se, do të paraqitemi për verifikimin e makinerive dhe pajisjeve të deklaruara nga ana juaj, në datë 04.07.2022 ora 13:00, pranë ambienteve të selisë tuaj qendrore.”*

II.13. Gjithashtu, nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet, se autoriteti kontraktor në datë 04.07.2022, në rubrikën “Kërkesa”, me anë të kërkesës “*Njoftim për verifikim*”, ka njoftuar përsëri operatorin ekonomik “Rej” SHPK se: “*Në vijim të njoftimit datë 01.07.2022, nga i cili nuk patëm asnjë konfirmim nga ana juaj, ju njoftojmë se KVO do të paraqitet ditën e nesërme, datë 05.07.2022 ora 10:00 pranë selisë tuaj qendrore për verifikimin e makinerive dhe pajisjeve të deklaruara nga ana juaj në ditën e hapjes së ofertave. Kërkojmë nga ana juaj, të merren masa për paraqitjen e mjeteve dhe pajisjeve përpara KVO, sipas përcaktimit në DST.”*

II.14. Në datën 04.07.2022, konstatohet se operatori ekonomik “Rej” SHPK, i ka kthyer përgjigje autoritetit kontraktor, në rubrikën “Kërkesa”, në Sistemin e Prokurimit Elektronik si më poshtë: “*Në datën 04.07.2022 jemi njohur në SPE me kërkesën për Verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara me procedurën “Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës. Jeni të mirëpritur në datën 05.07.2022 ora 10 siç ju e keni përcaktuar.”*

II.15. Nga verifikimi i dokumentacionit të autoritetit kontraktor, të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën objekt-shqyrtimi, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka dorëzuar dokumentin *Procesverbal nr.5 “Mbi verifikimin e makinerive, pajisjeve të “Rej” SHPK”,* i mbajtur në datë 05.07.2022, në ambientet e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe përfaqësuesi i operatorit ekonomik “Rej” SHPK, me përmbajtje:

*“Në mbështetje të pikës 3, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST, nga verifikimi në prani të përfaqësuesve të OE, rezultoi se:*

<i>Nr.</i>	<i>Emri i mjetit</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasitë minimale</i>	<i>Komente</i>
<i>1</i>	<i>Dy makineri larese per ambientet e brendshme</i>	<i>copë</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Numatic 1840</i>
<i>2</i>	<i>Vinç me kosh per larjen e dritareve ne lartesi</i>	<i>copë</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Po</i>
<i>3</i>	<i>Makine per larjen e rrugeve (Autobot) te pajisur me pompe per larjen e rrugeve me presion, pajisur me tub per nxjerrjen e ujit ne pjeset anesore te tij, me kapacitet mbajtes minimumi 7000 deri ne 8000 litra ujë</i>	<i>copë</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>PO</i>

II.16. Në datën 13.07.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Konfirmimin e fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), ku konstatohet, se fitues është shpallur operatori ekonomik “Rej” SHPK.

II.17. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), konstatohet, se në datën 13.07.2022, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit, si më poshtë vijon:

1. BOE “Meteo” SHPK & “Pastrime Silvio” SHPK	106,899,711.43	I skualifikuar
2. “Rej” SHPK	113,365,021.65	I skualifikuar
3. “Clean Fast” SHPK	120,053,102.18	I skualifikuar
4. “Alko Impex General Construction” SHPK	121,432,903.81	I skualifikuar
5. “Sori Al” SHPK	136,612,710.76	I skualifikuar

II.18. Operatori ekonomik “Rej” SHPK skualifikohet në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

*1. Arsyeja e skualifikimit për “REJ” SHPK Ofertuesi nuk përmbush piken 3/2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim, pasi në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore, operatorët ekonomike duhet të paraqesin pranë AK, jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar, dokumentacion për pajisjet, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente*

*zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Pas publikimit të njoftimit të fituesit për OE “REJ” SHPK në SPE në datë 07.06.2022, ofertuesi me paraqitjen e dokumenteve në kopje origjinale dhe të noterizuar në datë 08.06.2022, nuk paraqiti asnjë dokument që provon disponueshmerinë/pronesinë e “dy makina larëse për ambientet e brendshme”. Sipas nenit 1 të kontratës për shitje mjetes me kusht date 15.03.2022, shitja e këtyre pajisjeve kushtezohet nga shpallja fitues në këtë procedurë prokurimi. Si rrjedhim, ofertuesi kishte detyrimin që të paraqiste dokumentin provues të fitimit të pronësisë të 2 pajisjeve, brenda 5 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit. Edhe pas verifikimit në ambientet e OE të pajisjeve në datë 05.07.2022, ofertuesi nuk arriti të paraqesë në prezencë të AK, as fizikisht dhe as të provonte me dokumentacion disponueshmerinë e 2 cope makinerive larëse për ambiente të brendshme model RAPID 30 SM 45 BC TOUCH të ËIRBEL, objekt i kontratës së shitjes me kusht date 15.03.2022, i deklaruar në SPE. Referuar proces verbalit të verifikimit të mjeteve të mbajtur në prezencë të KVO dhe perfagesuesit të ofertuesit, janë prezantuar fizikisht, 2 mjete larëse model NUMATIC 1840, të cilat nuk përputheshin me modelin objekt i kontratës së shitjes me kusht (me të dhëna teknike me të ulëta), për të cilat gjithashtu nuk kishte paraqitur asnjë dokument provues për disponueshmerinë e tyre.*

II.19. Në datën 15.07.2022 autoriteti kontraktor, ka kryer Publikimin e Njoftim Anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.20. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 25.07.2022 operatori ekonomik “Rej” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik protokolluar me nr. 1609 prot., datë 25.07.2022. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Rej” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.21. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.1609/2 prot., datë 27.07.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Rej” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.22. Njëpërmjet shkresës me nr. 1215/3 prot., datë 09.08.2022, protokolluar me tonën me nr. 1609/3 prot., datë 09.08.2022 me objekt “Dërgim vendimi mbi ankesën”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik shkresa nr. 1215/2 prot., datë 08.08.2022 me objekt “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës së ankimuesit “Rej” SHPK”, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.23. Nëpërmjet shkresës me nr. 1289 prot., datë 09.08.2022, protokolluar me tonën me nr. 1609/4 prot., datë 10.08.2022 me objekt “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacion lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK për kundërshtimin e ri-skualifikimit të ofertës së tij ekonomik, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 15.02.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit *E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*, me Nr. REF-REF-19625-02-14-2022, me objekt Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 137,991,275 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 17.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

III.1.2. Në datën 17.03.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.3. Në datën 06.04.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Meteo” SHPK & “Pastrime Silvio” SHPK	106,899,711.43	I skualifikuar
2. “Rej” SHPK	113,365,021.65	I skualifikuar
3. “Clean Fast” SHPK	120,053,102.18	I skualifikuar
4. “Alko Impex General Construction” SHPK	121,432,903.81	I skualifikuar
5. “Sori Al” SHPK	136,612,710.76	I skualifikuar

III.1.4. Në datën 06.04.2022 operatori ekonomik “Rej” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:



- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 1, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se shërbimet e mëparshme, të kryera gjatë 3 viteve të fundit, nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit. Furnizimet e mëparshme, të paraqitura në SPE nga ofertuesi, kanë si objekt pastrimin e rrugëve, grumbullimin dhe transportin e mbetjeve për qytetet Pogradec, Përrenjas, Vlore si dhe shërbime të tjera mirëmbajtje të cilat nuk përbëjnë përvoja të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit (shërbim pastrimi i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të godinës).*
- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur në tabelën e punonjësve, të dhëna mbi kontraktimin e 38 punonjësve sanitarë nga gjithsej 42 të kërkuar në pikën 2 seksioni 2.3 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim. Punonjësit sanitarë të deklaruar në listën e stafit nga ofertuesi në nr. rendorë 42 deri 51, rezultojnë të mos jenë të kontraktuar siç kerkohet në pikën 2 seksioni 2.3 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim.*
- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 3/2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se nuk disponon në pronësi ose me qira “dy makina larëse për ambientet e brendshme”. Për këtë kërkesë Ofertuesi ka paraqitur një kontratë blerje me kusht me subjektin Globi ShPK nga ku rezulton se kjo e fundit ka ende pronësinë e makinave larëse, në kundërshtim me kërkesën e AK ku kërkohet shprehimisht që subjekti ofertues të disponojë në pronësi ose qira mjetet e kërkuara në momentin e hapjes së ofertave.*
- *Ofertuesi nuk përmbush pikën 3/3, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se nuk disponon Makinë për larjen e rrugëve (Autobot) sipas kërkesave të AK. Nga leja e qarkullimit e paraqitur në SPE për autobotin AB048CF, rezulton se ky i fundit është dhënë me qira, pra nuk disponohet nga ofertuesi. Ndërsa, autoboti me targë AA294FF, referuar fotos së paraqitur, nuk rezulton të jetë siç kërkohet në DST, i pajisur me pompe për larjen e rrugëve me presion dhe i pajisur me tub për nxjerrjen e ujit në pjesët anesore të tij.*

III.1.5. Në datën 08.04.2022 autoriteti kontraktor, ka kryer Publikimin e Njoftim Anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike.

III.1.6. Në datën 15.04.2022 operatori ekonomik “Rej” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

III.1.7. Pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Rej” SHPK, KPP mori vendimin KPP 463/2022, datë 16.05.2022, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-19625-02-14-2022, me objekt “Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 137,991,275 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 17.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.8. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), konstatohet, se në datën 19.05.2022, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit, si më poshtë vijon:

1. BOE “Meteo” SHPK & “Pastrime Silvio” SHPK	106,899,711.43	I skualifikuar
2. “Rej” SHPK	113,365,021.65	I kualifikuar
3. “Clean Fast” SHPK	120,053,102.18	I skualifikuar
4. “Alko Impex General Construction” SHPK	121,432,903.81	I skualifikuar
5. “Sori Al” SHPK	136,612,710.76	I skualifikuar

III.1.9. Në datën 23.05.2022 autoriteti kontraktor, ka kryer Publikimin e Njoftim të Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

III.1.10. Gjithashtu, në datën 07.06.2022 autoriteti kontraktor, ka kryer përsëri Publikimin e Njoftim të Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

III.1.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të autoritetit kontraktor, të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën objekt-shqyrtimi, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka dorëzuar dokumentin “Procesverbal nr.4 i verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik “Rej” SHPK”, të mbajtur në datë 23.06.2022 nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe përfaqësuesi i Njësisë së Prokurimit me përmbajtje: “...Operatori ekonomik i shpallur fitues “Rej” SHPK, me shkresën protokolluar me tonë Nr.939 prot., datë 09.06.2022, ka paraqitur në formë të shkruar dokumentacionin si më poshtë...[...]. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm, rezulton se ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë dokument që provon disponueshmërinë/pronësinë e “Dy makina larëse për ambientet e brendshme”. Sipas nenit 1 të kontratës për shitje mjetesh me kusht datë 15.03.2022, shitja e këtyre pajisjeve kushtëzohet nga shpallja fitues në këtë procedurë prokurimi. Si rrjedhim,

ofertuesi kishte detyrimin që të paraqiste dokumentin provues të fitimit të pronësisë të 2 pajisjeve, brenda 5 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit. Pasi të kryhen verifikimet përkatëse për disponueshmërinë e pajisjeve të deklaruara siç përcaktohet në DST, dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi “Rej” SHPK, KVO do e përcjellë tek Njësia e prokurimit për ta bërë pjesë të dosjes së prokurimit”.

III.1.12. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për procedurën objekt-shqyrtimi, konstatohet, se autoriteti kontraktor në datë 01.07.2022, në rubrikën “Kërkesa”, me anë të kërkesës “Njoftim për verifikim”, ka njoftuar operatorin ekonomik “Rej” SHPK se: “Bazuar në pikën 3, shënim 5.1, seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik” të DST, sipas të cilës: “Autoriteti Kontraktor pas dorëzimit të dokumentacionit pas publikimit të njoftimit të fituesit përfundimtar, do të verifikojë pranë ambienteve të operatorit disponueshmërinë e pajisjeve të deklaruara”, ju njoftojmë se, do të paraqitemi për verifikimin e makinerive dhe pajisjeve të deklaruara nga ana juaj, në datë 04.07.2022 ora 13:00, pranë ambienteve të selisë tuaj qendrore.”

III.1.12. Gjithashtu, nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet, se autoriteti kontraktor në datë 04.07.2022, në rubrikën “Kërkesa”, me anë të kërkesës “Njoftim për verifikim”, ka njoftuar përsëri operatorin ekonomik “Rej” SHPK se: “Në vijim të njoftimit datë 01.07.2022, nga i cili nuk patëm asnjë konfirmim nga ana juaj, ju njoftojmë se KVO do të paraqitet ditën e nesërme, datë 05.07.2022 ora 10:00 pranë selisë tuaj qendrore për verifikimin e makinerive dhe pajisjeve të deklaruara nga ana juaj në ditën e hapjes së ofertave. Kërkojmë nga ana juaj, të merren masa për paraqitjen e mjeteve dhe pajisjeve përpara KVO, sipas përcaktimit në DST.”

III.1.13. Në datën 04.07.2022, konstatohet se operatori ekonomik “Rej” SHPK, i ka kthyer përgjigje autoritetit kontraktor, në rubrikën “Kërkesa”, në Sistemin e Prokurimit Elektronik si më poshtë: “Në datën 04.07.2022 jemi njohur në SPE me kërkesën për Verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara me procedurën “Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës. Jeni të mirëpritur në datën 05.07.2022 ora 10 siç ju e keni përcaktuar.”

III.1.14. Nga verifikimi i dokumentacionit të autoritetit kontraktor, të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën objekt-shqyrtimi, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka dorëzuar dokumentin *Procesverbal nr.5 “Mbi verifikimin e makinerive, pajisjeve të “Rej” SHPK”,* i mbajtur në datë 05.07.2022, në ambientet e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe përfaqësuesi i operatorit ekonomik “Rej” SHPK, me përmbajtje:

“Në mbështetje të pikës 3, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, të kriterëve të veçanta për kualifikim të DST, nga verifikimi në prani të përfaqësuesve të OE, rezultoi se:

<b>Nr.</b>	<b>Emri i mjetit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasitë minimale</b>	<b>Komente</b>
1	Dy makineri larese per ambientet e brendshme	copë	2 (dy)	Numatic 1840

2	<i>Vinç me kosh per larjen e dritareve ne lartesi</i>	<i>copë</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Po</i>
3	<i>Makine per larjen e rrugeve (Autobot) te pajisur me pompe per larjen e rrugeve me presion, pajisur me tub per nxjerrjen e ujit ne pjeset anesore te tij, me kapacitet mbajtes minimumi 7000 deri ne 8000 litra ujë</i>	<i>copë</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>PO</i>

III.1.15. Në datën 13.07.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Konfirmimin e fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), ku konstatohet, se fitues është shpallur operatori ekonomik “Rej” SHPK.

III.1.16. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), konstatohet, se në datën 13.07.2022, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit, si më poshtë vijon:

1. BOE “Meteo” SHPK & “Pastrime Silvio” SHPK	106,899,711.43	I skualifikuar
2. “Rej” SHPK	113,365,021.65	I skualifikuar
3. “Clean Fast” SHPK	120,053,102.18	I skualifikuar
4. “Alko Impex General Construction” SHPK	121,432,903.81	I skualifikuar
5. “Sori Al” SHPK	136,612,710.76	I skualifikuar

III.1.17. Operatori ekonomik “Rej” SHPK skualifikohet në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

*1. Arsyeya e skualifikimit për “REJ” SHPK Ofertuesi nuk përmbush piken 3/2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim, pasi në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore, operatorët ekonomike duhet të paraqesin prane AK, jo me vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit perfundimtar, dokumentacion për pajisjet, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Pas publikimit të njoftimit të fituesit për OE “REJ” ShPK në SPE në datë 07.06.2022, ofertuesi me paraqitjen e dokumenteve në kopje origjinale dhe të noterizuar në datë 08.06.2022, nuk paraqiti asnjë dokument që provon disponueshmerinë/pronesinë e “dy makina larëse për ambientet e brendshme”. Sipas nenit 1 të kontratës për shitje mjetesh me kusht date 15.03.2022, shitja e ketyre pajisjeve kushtezohet nga shpallja fitues në këtë procedurë prokurimi. Si rrjedhim, ofertuesi kishte detyrimin që të paraqiste dokumentin provues të fitimit të pronësisë të 2 pajisjeve, brenda 5 diteve nga publikimi i njoftimit të fituesit. Edhe pas verifikimit në ambientet e OE të pajisjeve në datë 05.07.2022, ofertuesi nuk arriti të paraqesë në prezencë të AK, as fizikisht dhe as të provonte me dokumentacion disponueshmerinë e 2 cope makinerive larëse për ambiente të brendshme model RAPID 30 SM 45 BC TOUCH të ËIRBEL, objekt i kontratës së shitjes me kusht date 15.03.2022, i*

*deklaruar ne SPE. Referuar proces verbalit te verifikimit te mjeteve te mbajtur ne prezencë te KVO dhe perfaqesuesit te ofertuesit, jane prezantuar fizikisht, 2 mjete larese model NUMATIC 1840, te cilat nuk perputheshin me modelin objekt i kontrates se shitjes me kusht (me te dhena teknike me te uleta), per te cilat gjithashtu nuk kishte paraqitur asnje dokument provues per disponueshmerine e tyre.*

III.1.18. Në datën 15.07.2022 autoriteti kontraktor, ka kryer Publikimin e Njoftim Anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike.

III.1.19. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 25.07.2022 operatori ekonomik “Rej” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik protokolluar me nr. 1609 prot., datë 25.07.2022. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Rej” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

III.1.20. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.1609/2 prot., datë 27.07.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Rej” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.21. Nëpërmjet shkresës me nr. 1215/3 prot., datë 09.08.2022, protokolluar me tonën me nr. 1609/3 prot., datë 09.08.2022 me objekt “Dërgim vendimi mbi ankesën”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik shkresa nr. 1215/2 prot., datë 08.08.2022 me objekt “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës së ankimuesit “Rej” SHPK”, ku konstatohet se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III.1.22. Nëpërmjet shkresës me nr. 1289 prot., datë 09.08.2022, protokolluar me tonën me nr. 1609/4 prot., datë 10.08.2022 me objekt “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbim pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacion lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.23. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe

informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

**2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.**

III.1.24. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

**i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;**

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

**6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

III.1.25. Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka detyrimin t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në rastin konkret KPP vërën, se momenti procedural i kërimit të dokumenteve origjinale dhe verifikimi i tyre nga ana e autoritetit kontraktor për operatorin ekonomik “Rej” SHPK, ka qenë minimumi data **19.05.2022**, datë në të cilën ankimesi është kualifikuar në sistemin e prokurimeve elektronike dhe maksimumi data **23.05.2022/07.06.2022** (pasi autoriteti kontraktor ka kryer dy herë Publikim Njoftim Fituesi në sistem), datë në të cilën është bërë publikimi i njoftimit-fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik për operatorin ekonomik “Rej” SHPK. Sikundër rezulton në faktet e parashtruara më sipër, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar përgjatë kësaj periudhe nga ana e ofertuesit të kualifikuar dorëzimin e dokumentacionit origjinal dhe verifikimin e kapaciteteve të cilat ishin përmbushur deri në atë moment me anë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

KPP vëren, se në dokumentacionin bashkëngjitur informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, gjendet dokumenti “Procesverbal nr.4 i verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik “Rej” SHPK”, të mbajtur në datë 23.06.2022 nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe përfaqësuesi i Njesisë së Prokurimit. Në këtë procesverbal citohet: “...Operatori ekonomik i shpallur fitues “Rej” SHPK, me shkresën protokolluar me tonë Nr.939 prot., datë 09.06.2022, ka paraqitur në formë të shkruar dokumentacionin si më poshtë...[...]. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm, rezulton se ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë dokument që provon disponueshmërinë/pronësinë e “Dy makina larëse për ambientet e brendshme”. Sipas nenit 1 të kontratës për shitje mjetesh me kusht datë 15.03.2022, shitja e këtyre pajisjeve kushtëzohet nga shpallja fitues në këtë procedurë prokurimi. Si rrjedhim, ofertuesi kishte detyrimin që të paraqiste dokumentin provues të fitimit të pronësisë të 2 pajisjeve, brenda 5 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit. Pasi të kryhen verifikimet përkatëse për disponueshmërinë e pajisjeve të deklaruara siç përcaktohet në DST, dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi “Rej” SHPK, KVO do e përcjellë tek Njësia e prokurimit për ta bërë pjesë të dosjes së prokurimit”.

Ndërkohë, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka kryer disa ditë më vonë, në datë 05.07.2022 verifikimin në terren të pajisjeve të operatorit ekonomik “Rej” SHPK.

Pra, veprimet e mësipërme të autoritetit kontraktor janë kryer, pas publikimit të njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik datë **23.05.2022/07.06.2022** (pasi autoriteti kontraktor ka kryer dy herë Publikim Njoftim-Fituesi në sistem), në kundërshtim me nenin 26 pika 6 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Ndërkohë pas këtij momenti, KPP vëren, se rivlerësimi i procedurës dhe skualifikimi sërish i operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK nga ana e autoritetit kontraktor, është bërë më datë 13.07.2022, pas verifikimit të dokumentacionit fizik të paraqitur pranë autoritetit kontraktor sipas Procesverbalit nr. 4, në datë 23.06.2022 të mbajtur nga autoriteti kontraktor dhe verifikimit në ambientet e operatorit ekonomik ankimues në datë 05.07.2022. Pra, konstatohet, se verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor, i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Rej” SHPK, mbi kapacitetet që deri në fazën e vlerësimit konsideroheshin të përmbushura me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, është bërë pas publikimit të njoftim-fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, në shkelje të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285 datë 9.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson edhe njëherë faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, apo akoma më tej dhe afatet për verifikim të parashikuara shprehimisht në ligj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e



ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka gabuar në zbatimin dhe interpretimin e ligjit në rastin konkret, pasi nuk ka marrë parasysh ndryshimet ligjore në lidhje me nenin 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ku parashikohet shprehimisht se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

III.1.26. Sa më sipër, KPP gjykon, se riskualifikimi në mënyrë të përsëritur i operatorit ekonomik ankimues është kryer në shkelje të parashikimeve ligjore aktualisht në fuqi. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të kishte verifikuar dokumentacionin origjinal të ankimuesit përpara veprimit procedural të publikimit të njoftim-fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike. KPP e gjen veprimin e autoritetit kontraktor, jo në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Akoma më tej, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka kryer veprime për zvarritjen e procedurës, pasi sikundër pasqyruar më sipër, ka kryer procesin e rivlerësimit të procedurës shumë kohë më pas nga momenti i publikimit të fituesit dhe ka vijuar më tej duke kryer rivlerësimin e procedurës pa asnjë mbështetje ligjore duke vendosur në fund edhe anulimin e procedurës. KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me momentin procedural të verifikimit të dokumentacionit origjinal dhe rivlerësimin e procedurës në shkelje të afateve ligjore dhe akoma më tej lidhur me anulimin e procedurës. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efijencës parashikuar në nenin 2 të LPP-së. Në këtë kuptim, KPP e gjen riskualifikimin e ankimuesit dhe anulimin e procedurës të pabazuar në ligj dhe në kapërcim të afateve ligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-19625-02-14-2022, me objekt “*Shërbim pastrimi, për Spitalin Universitar të Traumës*”, me fond limit 137.991.275 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 17.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Rej” SHPK, si dhe të korrigojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin mbi anulimin e procedurës.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rej” SHPK.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **K KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**